



Datë: 28.07.2025
Numër Protokolli: 5766/2025

A.nr.1072/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1072/2025, të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesi J.B, kundër organit të punësimit/Kuvendi i Kosovës, në çështjen juridike *“kompensim material”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 28.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.1072/2025, e datës 04.06.2025, e parashtruar nga ankuesi J.B.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil J.B (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 04.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes Nr.I-136/2525, të datës 02.05.2025 të Zëvendës Sekretarit të Kuvendit të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa, ky i fundit, më datë 20.06.2025, ka përcjell përgjigjen në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3773/2025, të datës 04.06.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.SP.09-01/24 të datës 16.09.2025 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Kuvendit të Kosovës; Kërkesë e ankuesit për kompensim e datës 27.03.2025; Përgjigjen e datës 01.04.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Kërkesën e ankuesit të datës 03.04.2025 për kompensim material; Përgjigjen e datës 02.05.2025 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Kuvendit të Kosovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 12.06.2025; Përgjigje në ankesë e datës 20.06.2025; Akt Emërimit e datës 10.10.2023 me përshkrimin e detyrave të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtuara nga palët në procedurë ka gjetur së ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Aktit të Emërimit AE.Nr.344/2019, të datës 10.10.2023, është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Lartë për analiza buxhetore dhe financiare* në Njësinë për Analiza Buxhetore dhe Financiare/Drejtoria për Hulumtim dhe Analizë në kuadër të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës përmes Vendimit Nr.SP.09-01/24, të datës 16.09.2024, ka caktuar me detyra shtesë në cilësi të Zyrtarit për Mbrojtjen e Dhënave, siç përcaktohet më Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton së ankuesi më datë 03.04.2025, i është drejtuar Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës, Njesisë së Burimeve Njerëzore si dhe Drejtorisë për Buxhet, me kërkesë për kompensim material në vlerën e 20% të pagës bazë dhe atë nga data 16.09.2024, duke iu referuar nenit 8 të Rregullores Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, me arsyetimin se pozita në të cilën është caktuar Zyrtar për Mbrojtjen e Dhënave sipas Vendimit të datës 16.09.2024, paraqet vëllim të shtuar të punës, ngase, pozita në fjalë ka detyra dhe përgjegjësi të tjera përveç atyre të përcaktuara me aktin e emërimit.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës, me datë 02.05.2025, në përgjigje të kërkesës së ankuesit të datës 03.04.2025, ka refuzuar të njëjtën me arsyetimin se Kuvendi i Republikës së Kosovës çështjen në fjalë e ka të rregulluar sipas Rregullores Nr.08-Rr-008 për Shtesat dhe Kompensimet mbi Pagën Bazë të Nëpunësit Civil të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu që, nëpunësi cili i Kuvendit të Kosovës për angazhimin shtesë në punë i takon shtesa mbi pagën bazë në vlerën prej 30% të pagës bazë, të përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 të kësaj rregullore ku parashihet se: *“Shtesat mbi pagën bazë i takon nëpunësit të Administratës së Kuvendit, bazuar në natyrën specifike të punës së Administratës së Kuvendit në mbështetje të punës së trupave punues të Kuvendit, që kërkon funksionimin efektiv të të gjitha shërbimeve në kohë dhe me përgjegjësi, punë nën presion kohor, punë me orar të zgjatur dhe të paparashikuar, si dhe kufizim në shfrytëzimin e pauzës ditore dhe të pushimit vjetor, për angazhimin shtesë në vlerën prej 30% të pagës bazë”*, ashtu që, ankuesi nuk mundet t'i realizoj dy shtesa në të njëjtën kohë.

Ankuesi në ankesën e parashtuar në Këshill pretendon se kërkesa e tij për kompensim material në vlerën e 20% të pagës bazë, është e bazuara, pasi gjen mbështetje në dispozita e aplikuar të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nenin 8 dhe 9 të Rregullores Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil i aprovuara sipas Vendimit Nr.08/226 të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me arsyetimin se pozita që mban sipas aktit të emërimit është pozita e përcaktuar në shërbimin civil kurse pozita në të cilën është caktuar sipas Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale paraqet detyra shtesë të përcaktuara sipas këtij ligji, shton me tej së nëpunësit civil të institucioneve tjera realizojnë shtesë për vëllim të punës nën kushte të njëjta, prandaj, arsyetimi i aktit të kontestuar nuk është i bazuar në ligj pasi që shtesa prej 30% mbi pagën bazë realizohet për shkak të marrëdhënies së punës në Kuvendin e Kosovës sipas nenit 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr.08-Rr-008 për Shtesat dhe Kompensimet mbi Pagën Bazë të Nëpunësit Civil të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu që, nuk do të thotë se organi i punësimit ka të drejtë të na ngarkojë me nga dy pozita të punës dhe të mos na kompensojë për punën e dytë shtesë. Kërkon që Këshilli të aprovoj si të bazuar ankesën të urdhërojë institucionin punëdhënës që të kompensoi të njëjtin në vlerën e 20% të pagës bazë dhe atë në mënyrë retroaktive nga data 16.09.2024.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, Kolegji i Këshillit ju referua Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, më theks të veçantë:

- Nenit 2, ku përcaktohet se: *“1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë;”*

-Nenit 22: shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; ... 2. Shtesa dhe kompensimi i nëpunëses/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese rregullohen me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucionit përkatës.

-Nenit 28 paragrafi 1 dhe 7: **“28. Shtesa për vëllimin e punës:** 1. Organizatat buxhetore, në rastet e parashikuara nga ky ligj, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunëseve/ve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta.... 7. Kriteret dhe procedura për përfitimin e shtesës sipas këtij neni, në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, **Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucioneve.”**

Referuar kuadrin ligjor si me sipër dhe nisur nga praktika e konsoliduar gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, Kolegji thekson faktin e pa kontestueshëm së Kuvendi i Kosovës ka pavarësi funksionale, organizative dhe buxhetore, pavarësi që konsiston në rregullim të këtyre çështjeve më akte të veçanta ligjore, mirëpo çdo herë duke respektuar parimet e përgjithshme që rrjedhin nga ligjet bazike.

Rrjedhimisht, Kryesia e Kuvendit të Kosovës me datë 05.06.2023, ka miratuar Rregulloren Nr.08-Rr-008 për Shtesat dhe Kompensimet mbi Pagën Bazë të Nëpunësit Civil të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe së në pajtim me nenin 4 paragrafi 1 të këtij akti nënligjor, të punësuarit civilë në Kuvendin e Kosovës për angazhimin shtesë realizojnë shtesë në vlerën prej 30% të pagës bazë, shtesë të cilën ankuesi e realizon (fakt ky i pohuar nga vet ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill). Andaj, mbi këtë bazë Kolegji vlerëson së në raport me të punësuarit civilë të Kuvendit të Kosovës dhe ndërlidhje më çështjet përkitazi më shtesat dhe kompensimet tjera përtej pagës bazë, aplikohen dhe gjejnë zbatim dispozitat e Rregullores Nr.08-Rr-008 për Shtesat dhe Kompensimet mbi Pagën Bazë të Nëpunësit Civil të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Referuar pretendimit se zyrtaret tjerë që ushtrojnë pozitën e zyrtarit për mbrojtje të dhënave realizojnë shtesë për vëllim të punës, ankuesi lidhur me këtë pretendim nuk ka afriar asnjë dëshmi që argumenton një pretendim të tillë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht refuzoj si të papabazuar ankesën e ankuesin.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1072/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit J.B;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Kuvendit të Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.